



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2026

**V E N D I M**

**Nr.13, datë 28.04.2026**

**PËR**  
**“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË**  
**KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP), PËR VITIN 2025”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

|             |                       |                |
|-------------|-----------------------|----------------|
| <b>Z.</b>   | <b>Gentian Sala</b>   | <b>Kryetar</b> |
| <b>Znj.</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Armer Juka</b>     | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Bleron Dokle</b>   | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Znj.</b> | <b>Diana Dervishi</b> | <b>Anëtar</b>  |

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 28 prill 2026 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” miratuar me vendimin nr. 11, datë 31.3.2026 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimin e raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunimimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2025”.

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 7 e nenit 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Neni 8 i ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.
3. Vendim nr. 11, datë 31.3.2026 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

- Relacioni shoqërues i projektvendimit;
- Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
- Projektraporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2025.

### **V Ë R E N:**

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që ka hyrë në fuqi më 20 dhjetor 2024, ka transpozuar pjesërisht Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11.12.2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”.
2. Projektraporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2025 dhe përfshin një analizë të detajuar sipas kapitujve tematikë si komunikimet elektronike, tregu postar, mbrojtja e konsumatorit, administrimi dhe menaxhimi i burimeve të fundme si dhe zhvillimi institucional.
3. Raporti vjetor i veprimtarisë së AKEP për vitin 2025, i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, nenit 8 të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë si dhe vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të pikës 1 të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2025, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al), së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2025.
3. Ngarkohet administrata e AKEP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

|                     |                       |                   |                     |                       |
|---------------------|-----------------------|-------------------|---------------------|-----------------------|
| <b>Kryetar</b>      | <b>Anëtar</b>         | <b>Anëtar</b>     | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>         |
| <b>Gentian Sala</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Armer Juka</b> | <b>Bleron Dokle</b> | <b>Diana Dervishi</b> |